



Prishtinë: 24.06.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1533\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_2310\_06\_22**.

në seancën e mbajtur më datë **24.06.2022** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit **SH.B** nga Komuna e Gjakovës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. **KESCO** duhet të anulohet korrigjimin plotësuese nr. 27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021 në vlerë **627.85€**

### A r s y e t i m

**SH.B** me datë 15.12.2021 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr. 27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021.

Me datë 11.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35716903 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00036,517 kWh dhe TU=00007,842 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=00028,384 kVAR dhe TU=00000,230 kVAR. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se behet ndërrimi i instalimit të Grupit matës dhe TMRR si dhe njehsori elektrik ka regjistruar në 2.8.0.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0202920 datë 11.11.2020

Me datë 16.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35716903 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00137,390 kWh dhe TU=00012,620 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=000124,040 kVAR dhe TU=00000,855 kVAR. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që është bërë kontrollimi i grupit matës si dhe TMRR dhe për momentin gjithçka është në rregull. Po ashtu është evidentuar në procesverbal se tensioni është shumë i dobët dhe se nuk aktivizohen makinat e punës dhe se konsumatori punon me gjenerator.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr. 030117 datë 16.11.2021



Departamenti i faturimit në KEDS me datë 30.04.2021 e ka ngarkuar konsumatorin me korrëgjim plotësuese nr. 27194DGJ-9021910 në vlerë financiare **627.85€** duke bërë korrëgjimin plotësues për periudhën 12/2019 deri ne periudhën 11/2020 per shkak te mos regjistrimit te saktë te shpenzimeve.  
**Provë:** Korrëgjimi nr. 27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021

Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrëgjim plotësuese nr. 27194DGJ-9021910 te datës 30.04.2021.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit ne KESCO

Me datë 21.05.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0009457 i datës 11.09.2019 te grupi matës është konstatuar: Ndërlidhja e gabuar sipas formulimeve adekuate kemi se fuqia e saktë e konsumuar shprehet sipas barazisë:  $PS = \sum(U \cdot I \cdot \cos\phi) = 3 \cdot U \cdot I \cdot \cos\phi$ , ndërsa ajo e matur  $Pf1 = U \cdot I \cdot \cos\phi$ ,  $Pf2 = U \cdot I \cdot (120 + \cos\phi)$  dhe  $Pf3 = U \cdot I \cdot (120 - \cos\phi)$ . Pas transformimeve dhe diuke marr per baze qe njehsori mate ne dy kahjet A+ dhe A- del rezultati:  $Pm = Pm + Pm - = \frac{1}{2} \cdot U \cdot I \cdot (2 \cos\phi + \sqrt{3} \sin\phi) - \frac{1}{2} \cdot U \cdot I \cdot (2 \cos\phi + \sqrt{3} \sin\phi)$ , prej nga  $Pm + = Pm -$ . Saktësisht ka mbetur pa u faturuar energjia e regjistruar si negative se bashku me fuqinë përkatëse (maksigrafin e njëjtë), kjo prezantohet si  $PS = 2 \cdot Pm = 2 \cdot Pm -$ .

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 21.05.2021

Me datë 15.12.2021 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohen korrëgjimet plotësuese nr.27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 15.12.2021

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 11.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 35716903 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv  $TL = 00036,517$  kWh dhe  $TU = 00007,842$  kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv  $TL = 00028,384$  kVar dhe  $TU = 00000,230$  kVar. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal se behet ndërrimi i instalimit te Grupit matës dhe TMRR si dhe njehsori elektrik ka regjistruar ne 2.8.0. DMK ka analizuar procesverbalin e kontrollimit te grupit matës dhe konstaton se ekipi i matjeve te KEDS-it nuk kane ofruar asnjë te dhënë mbi intervenimet ne njehsorin elektrik pra nuk ka bere përshkrimin e intervenimit ne sistemin e instalimit dhe rregullimit të matjes.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 30.04.2021 e ka ngarkuar konsumatorin me korrëgjim plotësuese nr. 27194DGJ-9021910 në vlerë financiare **627.85€** duke bërë korrëgjimin plotësues për periudhën 12/2019 deri ne periudhën 11/2020 per shkak te mos regjistrimit te saktë te shpenzimeve. Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrëgjim plotësuese nr. 27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021. Me datë 21.05.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij me arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0009457 i datës 11.09.2019 te grupi matës është konstatuar: Ndërlidhja e gabuar sipas formulimeve adekuate kemi se fuqia e saktë e konsumuar shprehet sipas barazisë:  $PS = \sum(U \cdot I \cdot \cos\phi) = 3 \cdot U \cdot I \cdot \cos\phi$ , ndërsa ajo e matur  $Pf1 = U \cdot I \cdot \cos\phi$ ,  $Pf2 = U \cdot I \cdot (120 + \cos\phi)$  dhe  $Pf3 = U \cdot I \cdot (120 - \cos\phi)$ . Pas transformimeve dhe diuke marr per baze qe njehsori mate ne dy kahjet A+ dhe A- del rezultati:  $Pm = Pm + Pm - = \frac{1}{2} \cdot U \cdot I \cdot (2 \cos\phi + \sqrt{3} \sin\phi) - \frac{1}{2} \cdot U \cdot I \cdot (2 \cos\phi + \sqrt{3} \sin\phi)$ , prej nga  $Pm + = Pm -$ .



Saktësisht ka mbetur pa u faturuar energjia e regjistruar si negative se bashku me fuqinë përkatëse (maksigrafin e njëjtë), kjo prezantohet si  $PS=2*P_m=2*P_m-$ . Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe analizën e te dhënave të bere nga komisioni për korrigjime me datë 23.03.2021 e ku theksohet se analizat janë bërë si në diagramin ditore vektorial DV, në diagramin ditore të ngarkesës LP të njehsorit elektrik ashtu edhe në të dhënat e leximeve DRO ku vërehet se parametrat dhe matjet kanë funksionuar në rregull sipas parametrave teknik të dhënë nga sistemi i TMRR dhe janë regjistruar parametrat teknik sipas vlerave të konsumit të konsumatorit. Mirëpo është theksuar se sipas analizave nuk ka adekuesi të tensioneve dhe rrymave përkatëse, gjegjësisht rryma e fazës së parë është në përshtatshmëri me tensionin e fazës së parë përderisa rryma e fazës së dytë ndërlidhet në sistemin matës të njehsorit të fazës së tretë me tensionin e tretë dhe anasjelltas për sistemin e dytë të njehsorit ku kemi lidhje të rrymës së fazës së tretë me tensionin e fazës së dytë.

Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO nr. 27194DGJ-9021910 datë 30.04.2021 e i cili është bërë duke u thirrur në nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së OSSH-së dhe konstaton se kjo nuk qëndron pasi që neni 4.11.1 përcakton rastet kur njehsori elektrik është teknikisht jo në rregull ku edhe thuhet se: "Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0, kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit përkatësisht 6 muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë, atëherë veprohet siç u tha më lart.

***Bordi i ZRRE gjatë analizimit të korrigjimit vëren se për korrigjimin plotësues KESCO ka evidentuar shpenzimet/vlerën e faturuar në periudhën dhjetor 2020 e që nëse shikohen listat e leximit si dhe rryedha e energjisë elektrike vërehet se për korrigjim janë marr shpenzimet e regjistruara dhe faturuara në periudhën shkurt 2021 e që kjo bie në kundërshtim me të dhënat e korrigjuara.***

Në raportin mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0202920 datë 11.11.2020 të përpiluar nga ekipet e KEDS-it nuk është evidentuar arsyeja e lidhjeve të gabuara përkatësisht problemet e paraqitura para ndërrimit apo ndryshimit të kyçjeve duke pasur parasysh se leximi i pikës matëse është bërë nga distanca me AMR dhe se të gjitha shpenzimet regjistrohen dhe monitorohen në kohë reale si dhe njehsori është vendosur për matje në periudhën 06/2013. Po ashtu KEDS nuk ka ofruar asnjë procesverbal mbi kontrollimin e GM ashtu siç parashihet edhe me Kodin e matjes.

Bazuar në kodin e matjes përkatësish nenin 3.9.4 dhe 3.9.5 (Testimi i njehsorëve me pajisje portabel) si dhe nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave të caktuara kohore si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Në nenin 3.9.4 thuhet se: Njehsorët gjysmë indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR duhet që së paku 1 (një) herë në dy vite ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër të testohen", kurse në nenin 3.9.5 thuhet se: "Testimi i përbashkët në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht TMRR, TMT, Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose në çdo gjashtë muaj varësisht nga rasti që paraqitet, e që në rastin e konsumatorit **SH.P** asnjë rast nuk është respektuar kurse në nenin 4.3.2 thuhet se: "Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e



mirëfilltë të kabllave, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plombave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga KEDS konstatohet se nenet 3.9.4 dhe 3.9.5 nuk janë respektuar nga KEDS per periudhën 06/2013 deri ne periudhën 11/2020 pasi që nuk është ofruar asnjë dokument me te cilët vërtetohet shqyrtimi periodik I grup matësit te konsumatorit kurse neni 4.3.2 vërteton përgjegjësin e OSSH-së per grup matësin nr. 35716903. Po ashtu me Ligjin per Energjinë Elektrike, neni 54 paragrafi 1 thuhet se: ***Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.***

Me datë 16.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 35716903 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00137,390 kWh dhe TU=00012,620 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=000124,040 kVAr dhe TU=00000,855 kVAr. ***Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal qe është bere kontrollimi i grupit matës si dhe TMRR dhe per momentin gjithçka është ne rregulle. Po ashtu është evidentuar ne procesverbal se tensioni është shume i dobët dhe se nuk aktivizohen makinat e punës dhe se konsumatori punon me gjenerator.*** Ne baze te te gjeturave vërtetohet se ekipi i KEDS nuk ka dhënë asnjë rekomandim per përmirësimin e furnizimit te konsumatorit bazuar ne standardet e parapara dhe aprovuara.

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, Raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0202920 datë 11.11.2020, mos respektimin e neneve 3.9.4 dhe 3.9.5 te Kodit te matjes që kanë te bëjnë me inspektimin dhe testimin e pajisjeve matëse multifunksionale (GP) brenda periudhës se caktuar, nenin 4.3.2 të Kodit të matjes me te cilin është e përcaktuar përgjegjësia e mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik si dhe nenin 54 paragrafin 1 të Ligjit per Energjinë Elektrike, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: **SH.B**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.